



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 54, datë 14.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT TË KRIJUAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, E SHPALLUR NGA KUVENDI I
SHQIPËRISË NË DATËN 28.08.2018, E RISHPALLUR NË DATËN 21.08.2019
DHE E RISHPALLUR NË DATËN 24.09.2020.**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229 dhe nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 71 e 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi përfundoi vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit të lejuar për këtë vend vakant, si dhe miratoi listën përfundimare të renditjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018, e rishpallur në datën 21.08.2019 dhe e rishpallur në datën 24.09.2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARË

Vitore TUSHA

